

12. Çka quajmë fitim kapital?

Fitimet kapitale janë të ardhura, të cilat tatimpaguesi i realizon përmes shitjes së pasurive kapitale, duke përfshirë pasurinë e patundshme dhe letrat me vlerë. E ardhura e cila realizohet nënkupton dallimin pozitiv në mes të të hyrave nga shitja e pasurisë kapitale sipas çmimit të shitjes dhe vlerës neto në libra. Ndërsa me rastin e shitjes së asetëve nga llogaria grupore, nuk njihet fitimi kapital.

13. Çka quajmë humbje kapitale?

Humbjet kapitale janë humbje, të cilat tatimpaguesi i pëson përmes shitjes së pasurisë apo letrave me vlerë. Humbja e cila realizohet nënkupton dallimin negativ nga shitja e pasurisë kapitale sipas çmimit të shitjes dhe vlerës neto në libra rritur me shpenzimet e përmirësimeve eventuale dhe e zvogëluar për pjesën e zhvlerësimit. Ndërsa në rastin e shitjes së asetëve nga llogaria grupore, nuk njihet humbje kapitale.

14. Cilat janë afatet kohore për deklarim?

Afatet e pagesës së kësteve paradhënie janë deri në çdo 15 të muajit vijues pas çdo tremujori. Afati për dorëzimin e deklaratës vjetore për Tatimin në të Ardhurat e Korporatave deri më 31 mars të vitit pasues të periudhës tatimore.

Rreth

20%

e të hyrave të ATK-së vijnë nga Tatimi në të Ardhurat e Korporatave

“
Pagesa e tatimit, siguron
qëndrueshmëri të
ekonomisë në vend!
”

Kontaktet e ATK-së

Nëse keni nevojë për më shumë informacione, ne ju inkurajojmë që të shqyrtoni ligjet dhe udhëzimet administrative përkatëse. Këto janë në dispozicion në faqen tonë të internetit www.atk-ks.org. Nëse nuk jeni në gjendje të gjeni përgjigje për pyetjet tuaja, stafi i ATK-së është në dispozicion për të ju ndihmuar, prandaj drejtohu në zyret më të afërta të ATK-së:

Qeveria e Kosovës - Vlada Kosova - Government of Kosovo
Ministria e Financave - Ministarstvo za Finansije - Ministry of Finance
Administrata Tatimore e Kosovës - Poreska Administracija Kosova - Tax Administration of Kosovo

Telefonat: ZYRETORE DHE PAGESAVE PER TATIMIN NE TE ARDHURAT E KORPORATAVE

CD

[1] Periudha e Deklarimit: NJTM : 038/200 346 41

[3] Numri i Fiskal: []

[4] Emri i tatimpaguesit: Prishtina-1: 038/200-255-21

[5] Adresa e tatimpaguesit: []

[6] Prorari: Prishtina-2: 038/200-255-02 Telefoni: []

[7] Menaxheri: Prishtina-3: 038/200-255-17 Telefoni: []

[8] Kontabiliteti sipas libërve: [] Telefoni: []

[9] Nëse deklaranta tatimor është plotësuar me herët për të njëjtin periudhë, vendose 'X' në kutinë që përshkruan llojin e ndryshimit. (Ju lutemi referohuni udhëzimit për plotësim)

Shtesa Korrigjim Vajtëm pagesë

Peja: 039/432-812

Ferizaj: 0290/321-668

Gjilani: 0280/326-967

[48] Shuma obligative (Barteni shumën nga kuta [43]) []

Mitrovica: 028/590-667

[49] Shuma e tatimit të paguar []

Gjakova: 0390/330-021

Zyra Qëndrore: 038/200-250-17

Linja e përbashkët pa pagesë:

0800-80-800

Una deklarim... Data: []

Pjesa e bankës

Nënshtetësi dhe vula Numri i llogarisë: 1000420070000373 Shuma e tatimit të paguar

Adresa: Këndi i rrugëve Bill Clinton & Dëshmorët e Kombit
10000 Prishtinë, Kosovë
Tel & Fax: +381 (0)38 200 250 17 & 200 250 07
Email: info@atk-ks.org; Web: www.atk-ks.org

Nr. Formës CD... K019



Administrata Tatimore e Kosovës
Poreska Administracija Kosova
Tax Administration of Kosovo

PYETJE - PËRGJIGJE
PËR TATIMIN NË TË
ARDHURAT E KORPORATAVE

Fletëpalosja me Pyetje dhe Përgjigje bazuar në Ligjin Nr. 03/L - 162 për Tatimin në të Ardhurat e Korporatave, ka për qëllim Edukimin dhe Informimin e Tatimpaguesve për të drejtat dhe detyrimet e tyre, të cilat rrjedhin nga Tatimi në të Ardhurat e Korporatave.

1. Cili është përkufizimi i Korporatës?

Korporatë - person juridik, i cili ka një identitet që është i ndarë dhe dallon nga anëtarët, pronarët dhe aksionarët. Një shoqëri tregtare, kapitali i së cilës është i ndarë në numër të specifikuar të aksioneve të së njëjtës vlerë nominale.

2. Kush është objekt i Tatimit në të Ardhurat e Korporatave?

Objekt i tatimit për tatimpaguesin rezident janë të ardhurat e tatueshme nga burimet e të ardhurave në Kosovë dhe burimit të të ardhurave të jashtme. Objekt i tatimit për tatimpaguesin jo rezident janë të ardhurat e tatueshme nga burimi i të ardhurave brenda Kosovës.

3. Cila është norma e Tatimit në të Ardhurat e Korporatave në Kosovë?

Norma e tatimit në korporata është :

10% Norma e tatimit në korporata

4. Cilët janë tatimpaguesit për TAK?

- Një korporatë apo ndonjë ndërmarrje tjetër afariste që ka statusin e personit juridik sipas ligjit në fuqi në Kosovë;
- Një shoqëri tregtare që vepron me pasuri në pronësi shoqërore ose publike;
- Një organizatë e regjistruar si organizatë jo qeveritare sipas Legjislacionit që rregullon regjistrimin dhe funksionimin e OJQ-ve, në Kosovë;
- Person jo rezident me njësi të përhershme në Kosovë, duke iu nënshtruar paragrafit 2 të nenit 4 të këtij Ligji.

5. Si është e organizuar Korporata për çështje tatimore dhe cili është kriteri në bazë të qarkullimit?

Korporatë e Madhe > 50.000 Euro

Korporatë e Vogël < 50.000 Euro

6. Një Korporatë e Vogël, a mund të deklarojë detyrimet tatimore në baza reale?

Po, një Korporatë e Vogël mund të zgjedhë që të deklarojë në baza reale nëse dorëzon një pasqyrë (kërkesë) në ATK deri më 1 Mars të periudhës aktuale

7. Si të shkarkohet formulari për TAK?

Shko në faqen e internetit të ATK-së www.atk-ks.org dhe klikoni mbi pjesën **Shkarko deklaratë elektronike** në anën e majtë të navigimit.



Shkruani numrin fiskal të korporatës tuaj. Emri i saj duhet të shfaqet automatikisht. (Nëse jo, sigurohuni që keni shkruar NF të saktë), zgjidhni formularin, zgjidhni periudhën tatimore dhe **merrni deklaratën**.

8. Cilat janë shpenzimet e palejueshme?

Shpenzime në vijim janë të palejueshme:

- Kostoja e përvetësimit dhe përmirësimit të tokës;
- Kostoja e blerjes, përmirësimit, ripërtëritjes dhe rindërtimit të aseteve që janë kapitalizuar dhe zhvlerësuar ose amortizuar; Tatimi në të Ardhura; TVSH-ja e zbritshme; Humbjet nga shitja ose këmbimi i pronës ndërmjet personave të lidhur; Kontributet pensionale mbi shumën maksimale të lejuar me ligj pensional të Kosovës.

9. Si janë të përcaktuara shpenzimet në emër të reprezentacionit?

Shpenzimet e ndodhura të reprezentacionit, do të jenë të kufizuara në 50% të shumës së faturuar për zbatimje afariste. Shuma maksimale e shpenzimeve të reprezentacionit nuk do të tejkaloj 2% të të ardhurave bruto vjetore.

10. Kur mund të njihet borxh i keq?

Pjesa e llogarive të arkëtueshme të tatimpaguesve e cila vihet në dyshim për pagesë mund të kalojë në borxh të keq pasi që t'i ketë plotësuar disa kushte gjegjësisht të jenë marrë të gjithë hapat e nevojshëm ligjor për arkëtimin e tyre.

11. Cila është baza për llogaritje të zhvlerësimit?

Bazë për llogaritje të zhvlerësimit janë kostot e blerjes apo prodhimit duke përfshirë edhe të gjitha kostot e drejtpërdrejta të cilat janë të domosdoshme për të vënë një aset në gjendje gatishmërie për shfrytëzim.